



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



# Monitorimi i Investimeve kapitale të KRU “Prishtina” sh. a Prishtinë

Verifikimi i listës së investimeve kapitale të përcaktuara  
gjatë procesit tarifor 2022/2024, për vitin 2024.



AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT - ARRU

## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| HYRJE   | 3  |
| Investimet kapitale në këtë sektor kanë këto përfitime, por jo vetëm: .....                     | 4  |
| Investimet kapitale dhe kategorizimi i aseteve .....  | 4  |
| Asetet infrastrukturore në përgjithësi përfshijnë: .....  | 4  |
| Asetet e tjera (kryesisht mbi tokë) klasifikohen si jo infrastrukturore. Këto përfshijnë: ..... | 5  |
| Shpenzimet për investime kapitale – mirëmbajtja kapitale e infrastrukturës .....                | 5  |
| Shpenzimet kapitale për investime – përmirësimi i infrastrukturës .....                         | 6  |
| Shpenzimet kapitale për asete jo infrastrukturore.....  | 6  |
| Ndikimi i investimeve kapitale në tarifa.....   | 7  |
| Rëndësia e monitorimit të investimeve kapitale .....  | 7  |
| Metodologjia e punës për monitorimin e investimeve kapitale .....                               | 8  |
| Takimet në KRU për monitorimin e realizimit të listës së investimeve kapitale .....             | 8  |
| Investimet e aprovuara për KRU "Prishtina" .....  | 9  |
| Investimet e realizuara nga KRU-të sipas procesit të auditimit të të dhënave.....               | 9  |
| Konkluzione.....  | 12 |
| Rekomandime .....   | 12 |

## **HYRJE**

Investimet kapitale në industrinë e shërbimeve të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura janë thelbësore për të siguruar qëndrueshmërinë, cilësinë dhe furnizimin e qëndrueshëm të ujit për konsumatorë. Këto investime përfshijnë ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujit, por jo të kufizuara vetëm tek ato, si p.sh.:

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të shpërndarjes së ujit: Kjo përfshin zëvendësimin e gypave të vjetra dhe instalimin e gypave të reja për të përmirësuar efikasitetin e shpërndarjes së ujit dhe për të reduktuar humbjet e ujit.
- Përmirësimi i impianteve të trajtimit të ujit: Investimet në teknologji të reja për trajtimin e ujit ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe në përputhjen me standardet shëndetësore.
- Ndërtimi i rezervuarëve dhe stacioneve të pompimit: Këto janë të nevojshme për të garantuar furnizimin e vazhdueshëm me ujë në periudhat e thatësirës dhe për të menaxhuar presionin e ujit në sistem.
- Automatizimi dhe monitorimi i rrjetit të ujit: Implementimi i sistemeve të menaxhimit të inteligjencës për monitorimin dhe kontrollin e rrjetit në kohë reale mund të ndihmojë në identifikimin e problemeve dhe ndërhyrjeve të shpejta për të minimizuar ndërprerjet në furnizim.
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit: është një investim kapital i rëndësishëm në infrastrukturën e shërbimeve të ujit dhe ka një ndikim të madh në cilësinë e jetesës, shëndetin publik dhe qëndrueshmërinë mjedisore, si dhe ndikojnë në parandalimin e përmbytjeve urbane.
- Rritja e kapaciteteve të trajtimit të ujërave të ndotura: Kjo përfshin ndërtimin e impianteve të reja ose zgjerimin e impianteve ekzistuese për trajtimin e ujërave të ndotura, duke reduktuar ndotjen dhe përmirësuar cilësinë e ujërave natyrore.

### **Investimet kapitale në këtë sektor kanë këto përfitime, por jo vetëm:**

- Përmirësimi i cilësisë së jetës: Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me ujë të pijshëm përmirëson shëndetin dhe mirëqenien e popullatës.
- Rritja e qëndrueshmërisë mjedisore: Përmirësimet në trajtimin e ujërave të ndotura dhe menaxhimin e burimeve të ujit ndihmojnë në mbrojtjen e ekosistemeve natyrore.
- Zhvillimi ekonomik: Një infrastrukturë e fortë e ujësjellësit është kritike për mbështetjen e zhvillimit industrial, duke kontribuar në rritjen ekonomike të vendit.
- Reduktimi i kostove afatgjata: Investimet në teknologji dhe infrastruktura moderne ndihmojnë në uljen e kostove operative dhe të mirëmbajtjes në afatgjatë.

Këto investime kërkojnë planifikim të kujdesshëm, financim të qëndrueshëm dhe mbështetje të fortë politike dhe shoqërore për të arritur qëllimet e dëshiruara, e cila paralelisht kërkon bashkërendim dhe koordinim të aktiviteteve të gjithë palët e interesit në Kosovë.

### **Investimet kapitale dhe kategorizimi i aseteve**

Në industrinë e ujit dhe ujërave të ndotura bëhet një dallim për qëllime rregullatore ndërmjet:

- Asetet infrastrukturore: Asetet që kanë një jetëgjatësi të dobishme të papërcaktuar dhe të cilat, nëse mirëmbahen në mënyrë adekuate, duke përfshirë zëvendësimin dhe riparimin e madh të komponentëve me kalimin e kohës (mirëmbajtja kapitale), mund të pritet të ofrojnë një nivel shërbimi për konsumatorët për një periudhë të pacaktuar. Këto asete nuk i nënshtrohen zhvlerësimit. Në vend të kësaj, një tarifë për rinovimin e infrastrukturës (TRI) ofrohet në kërkesat për të ardhura dhe llogaritë rregullatore për të përfaqësuar mirëmbajtjen kapitale të funksionalitetit të aseteve nga biznesi gjatë vitit. Pasi këto asete nuk janë subjekt i zhvlerësimit, vlera në BRRA ruhet përjetësisht. Investimi në përmirësimin e rrjetit, duke përfshirë zgjerimin e rrjetit, përmirësimet në nivelet e shërbimit, përmirësimet në cilësi dhe mirëmbajtjen e kapitalit të akumuluar shtohet në BRRA në vend që të barten si pjesë e TRI-së. Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR) ofrojnë detaje të mëtejshme mbi procesin e rinovimit të infrastrukturës.
- Asetet jo infrastrukturore: Asetet ku jetëgjatësia është e përcaktueshme dhe mund të pritet të nxjerrën nga përdorimi ose zëvendësohen në fund të jetëgjatësisë së tyre të pritshme. Këto asete i nënshtrohen zhvlerësimit të kostos aktuale gjatë jetëgjatësisë së tyre të pritshme të dobishme.

### **Asetet infrastrukturore në përgjithësi përfshijnë:**

- Sistemet nëntokësore të rrjeteve dhe kanalizimeve.
- Grumbullimin dhe llojet e tjera të rezervuarëve për ruajtjen e ujit të papërpunuar.
- Digat.
- Tubacionet e llumit.
- Informacionin në lidhje me asetet infrastrukturore, p.sh. të dhënat e hetimeve zonale.

**Asetet e tjera (kryesisht mbi tokë) klasifikohen si jo infrastrukturore. Këto përfshijnë:**

- Pikat e mbledhjes së ujit.
- Stacionet e pompimit.
- Impiantet e trajtimit.
- Puset.
- Tokën operationale.
- Zyrat.
- Depot.
- Punëtoritë.
- Pronat rezidenciale, të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet operationale.
- Tokën e mbajtur, për të mbrojtur cilësinë e furnizimit me ujë të pijshëm.
- Impiantet dhe makineritë.
- Automjetet.
- Tokën e pashfrytëzueshme.

Të gjitha asetet e tjera që nuk janë përmendur më sipër ose si infrastrukture.

**Shpenzimet për investime kapitale – mirëmbajtja kapitale e infrastrukturës**

Industria e ujit dhe e ujërave të ndotura ka karakteristika që në masë të madhe e bëjnë të pavlefshëm përdorimin e zhvlerësimit, si përcaktues për shpenzimet e mirëmbajtjes kapitale të aseteve infrastrukturore për disa arsye:

- Asetet janë përgjithësisht me jetëgjatësi shumë të madhe, zakonisht më të gjatë se sa jeta e tyre kontabël. Kostoja aktuale e zëvendësimit të aseteve mund të jetë ndjeshëm më e lartë sesa kostoja fillestare e prokurimit, edhe pas llogaritjes së inflacionit.
- Jetëgjatësia e aseteve është kryesisht e papërcaktuar.
- Shumë asete janë plotësisht (financiarisht) të zhvlerësuara, por janë ende në funksion dhe kërkojnë mirëmbajtje kapitale për të ruajtur funksionalitetin e tyre.
- Asetet janë përgjithësisht të groposura dhe nuk janë të qasshme për inspektim për të përcaktuar jetëgjatësinë e mbetur.
- Zhvillimet teknologjike mund të çojnë në shpenzime për zëvendësim të aseteve që ndryshojnë ndjeshëm nga asetet e vjetra, edhe pas llogaritjes së inflacionit.

Për këto arsye, shumica e rregullatorëve të industrisë së ujit përdorin rinovimet e infrastrukturës duke llogaritur asetet e infrastrukturës së rrjetit<sup>1</sup>. Shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të infrastrukturës përkufizohen si shpenzimet që KRU do të priste zakonisht t'i kishte çdo vit për të ruajtur nivelin ekzistues (jo të përmirësuar) të funksionalitetit të aseteve të rrjetit. Tarifë për rinovimin e infrastrukturës (TRI) që pasqyron shpenzimet e pritura për rinovimet e infrastrukturës, llogaritet çdo vit dhe përfshihet në kërkesën për të ardhura. Kjo do të thotë që, në vend që të kufizohet shpenzimi për mirëmbajtje kapitale të aseteve infrastrukturore në atë që mund të përcaktohet nga një dispozitë për zhvlerësim, KRU-të duhet të përcaktojnë shpenzimet e nevojshme për të ruajtur nivelin e shërbimit dhe këto shpenzime, në thelb, do të reflektohen në

---

<sup>1</sup>

tarifat në të njëjtën mënyrë si shpenzimet operative. TRI përfaqëson shpenzimet e nevojshme për të ruajtur nivelet bazë të shërbimit dhe nuk përfshin shpenzimet për përmirësimin e infrastrukturës, të cilat përkundrazi shtohen në bazën rregullatore të aseteve (BRRRA). Përmirësimi i infrastrukturës përfshin shpenzimet e bëra për të mbuluar mospërputhjet historike të shpenzimeve për rinovimet e infrastrukturës, përmirësimin e cilësisë së ujit, nivelet e shërbimit dhe balancimin e kërkesë/ofertës (duke përfshirë zgjerimin e shërbimeve). Grantet kapitale dhe kontributet që i atribuohen rinovimeve të infrastrukturës nuk përfshihen në kërkesën për të ardhura.

### **Shpenzimet kapitale për investime – përmirësimi i infrastrukturës**

Investimet në përmirësimin e infrastrukturës përfshijnë:

- Zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit- për të përmbushur kërkesën në rritje për ujë dhe gjenerimin e ujërave të ndotura nga konsumatorët shtesë dhe rritjen e konsumit të ujit dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura nga konsumatorët ekzistues.
- Përmirësimet në rrjet - për të ofruar një përmirësim të përhershëm të niveleve të shërbimit, p.sh. për të përmirësuar ose menaxhuar më mirë presionin në rrjet.
- Përmirësimet në rrjet - për të ofruar një përmirësim të përhershëm të cilësisë së ujit- për të përmbushur standardet aktuale ose të reja të cilësisë së ujit, p.sh. zëvendësimi i gypave prej plumbit me gypa MDPE. Investimet, pa përfshirë grantet dhe kontributet kapitale, për përmirësimin/zgjerimin e infrastrukturës- shtohen në BRRRA. Pasi këto investime të jenë realizuar, çdo mirëmbajtje kapitale pasuese e tyre - trajtohet si rinovim i infrastrukturës. Investimet, pa përfshirë grantet dhe kontributet kapitale, për përmirësimin/zgjerimin e infrastrukturës- shtohen në BRRRA. Pasi këto investime të jenë realizuar, çdo mirëmbajtje kapitale pasuese e tyre - trajtohet si rinovim i infrastrukturës.

### **Shpenzimet kapitale për asete jo infrastrukturore**

Investimet kapitale në asete jo infrastrukturore, pa përfshirë grantet bartën në BRRRA-në jo infrastrukturore. Për qëllime të përcaktimit të tarifave, nuk është e nevojshme të bëhet dallim nëse një investim i tillë është për mirëmbajtje kapitale apo për përmirësim. Një dallim i tillë kërkohet për analizën e kërkesave dhe ende kërkohet në procesin e përcaktimit të tarifave. Bazuar në analizën fillestare të BRRRA-së fillestare në vitin 2008, jetëgjatësia mesatare e dobishme e aseteve jo infrastrukturore është përcaktuar në 35 vjet. Që nga viti 2009, BRRRA jo-infrastrukturore i është nënshtruar zhvlerësimit me normën 1/35 në të gjitha përcaktimet e tarifave. Kjo normë zhvlerësimi do të zbatohet, përveç, nëse KRU-të mund të ofrojnë dëshmi të qëndrueshme për të justifikuar një normë tjetër më të përshtatshme. Komponenti jo-infrastrukturor i BRRRA-së- i nënshtrohet zhvlerësimit sipas kostos aktuale me metodën e bilancit në rënie. Vlera fillestare e BRRRA-së i nënshtrohet zhvlerësimit për një vit të plotë. Investimet e reja konsiderohen të përfunduara në mes të vitit dhe i nënshtrohen zhvlerësimit prej 50% në vitin e realizimit. Vlera mbyllëse e BRRRA-së është vlera fillestare plus shtesat, minus nxjerrja nga përdorimi dhe zhvlerësimi. BRRRA mesatare për vitin (vlera fillestare plus vlera mbyllëse e pjesëtuar me dy) është baza për përcaktimin e kthimit nga BRRRA. Zhvlerësimi i kostos aktuale realizohet përmes rivlerësimit të BRRRA-së me normën e inflacionit të IÇK-së në fund të çdo periudhe të kontrollit të çmimeve

## **Ndikimi i investimeve kapitale në tarifa**

Investimet në asete infrastrukturore dhe jo infrastrukturore kontribuojnë në kërkesën për të ardhura në mënyra të ndryshme. Mirëmbajtja e planifikuar kapitale e grupit të aseteve infrastrukturore - kalon plotësisht në BARRA, pasi që IÇK ka insistuar në zhvlerësim. Si rrjedhojë, vlera e aseteve infrastrukturore ruhet përjetësisht. Shpenzimet për përmirësimin e aseteve infrastrukturore, zgjerimin/përforcimin për plotësimin e konsumit shtesë të ujit, përmirësimin e niveleve të shërbimit ose përmirësimin e cilësisë së ujit shtohen në BARRA dhe vlera e tij e shtuar ruhet përjetësisht. BARRA që përbëhet nga BARRA fillestar plus çdo përmirësim (pa zbritur zhvlerësimin) i nënshtrohet indeksimit me inflacion në secilën periudhë të rishikimit të tarifave. BARRA e indeksuar me inflacion i nënshtrohet një norme kthimi e cila bartet në kërkesën për të ardhura. Mirëmbajtja e planifikuar kapitale e grupit të aseteve jo-infrastrukturore i nënshtrohet zhvlerësimit të kostos aktuale që përfshihet në kërkesën për të ardhura. Shpenzimet faktike për investime kapitale në asete jo-infrastrukturore (mirëmbajtje kapitale dhe përmirësim) shtohen në BARRA dhe indeksohen me inflacion në secilën periudhë të rishikimit të tarifave. BARRA e indeksuar me inflacion i nënshtrohet një norme kthimi e cila bartet në kërkesën për të ardhura.

## **Rëndësia e monitorimit të investimeve kapitale**

Monitorimi i investimeve kapitale në industrinë e shërbimeve të ujësjellësit është një komponent kyç për të siguruar suksesin e projekteve, duke garantuar cilësi, efikasitet dhe transparencë. Ky proces jo vetëm që ndihmon në realizimin e projekteve brenda buxhetit dhe afateve kohore, por gjithashtu kontribuon në përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit afatgjatë të infrastrukturës së ujësjellësit. Raportimi i rregullt mbi realizimin e investimeve kapitale siguron që të gjitha palët e interesit të informohen në mënyrë të rregullt për progresin dhe ecurinë e projektit, dhe në këtë aspekt ARRU angazhohet seriozisht që raportimi dhe realizimi i investimeve kapitale të jetë një proces i vazhdueshëm dhe transparent. Monitorimi i vazhdueshëm krijon një mjedis të përgjegjshëm, ku të gjithë aktorët përfshirë kontraktorët dhe menaxherët e projektit mbajnë përgjegjësi për detyrat e tyre. Monitorimit të investimeve kapitale i kanë paraprirë dy aktivitete të nivelit qendror, e cila është kusht pastaj për gjithë sektorin që investimet kapitale të planifikohen mirë dhe monitorimi i tyre të jetë konsistent.

Këto aktivitete janë:

1. Shkresa nga Kuvendi i Kosovës, datë 3.08.2022, ku i bën thirrje të gjitha palëve të interesit në Kosovë që:
  - të sigurohet se të gjitha investimet e bëra ndër vite kanë dhënë rezultate konkrete në eliminimin e humbjeve të ujit.
  - Të realizohet auditim specifik i performancës nga ZKA (Zyra Kombëtare e Auditimit) duke pasur në fokus fushën e investimeve kapitale.
  - Të analizohet monitorimi i planit të investimeve kapitale, duke përfshirë edhe planin e veprimit, etj..

2. Raporti i Auditimit të Performancës nga ZKA “Ndikimi i investimeve kapitale në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe zgjerimin e shërbimeve tek qytetarët nga KRU-të”, i cili ndër të tjera ka dhënë rekomandimet:
  - ARRU duhet të sigurohet se përmes monitorimit po realizohen projektet e investimeve kapitale me kohë,
  - KRU-të duhet të hartojnë Planin e Menaxhimit të Aseteve dhe Planin e Investimeve Afatgjata në mënyrë që të ketë një planifikim të duhur të projekteve kapitale,
  - KRU-të duhet të sigurojnë se investimet kapitale të planifikuara në Planin e Biznesit duhet të jenë të harmonizuara me Biznes Planin Rregullator, etj..

### **Metodologjia e punës për monitorimin e investimeve kapitale**

Pikë referuese e analizës së krahasimit të të dhënave të investimeve kapitale për vitin 2024. Të dhënat e realizuara do të merren nga Raportet e Auditimit / Verifikimit të të dhënave të raportuara të KRU-së, ku merren për bazë kategoritë e investimeve kapitale sipas Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator. Lista e projekteve të aprovuara nga ARRU gjatë procesit tarifor krahasohet me listën e projekteve të realizuara nga KRU-ja për vitin respektiv.

Pra, metodologjia e punës analizon të dhënat e investimeve kapitale:

- Verifikimi i përmbushjes së caktimit të investimeve kapitale të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2024 dhe
- Verifikimi i listës së investimeve kapitale, projekt pas projekti, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022/2024, për vitin 2024.

### **Takimet në KRU për monitorimin e realizimit të listës së investimeve kapitale**

Për t’u ndërmarr ky aktivitet, Departamenti i Tarifave në kuadër të ARRU-së ka zhvilluar takim në KRU për të diskutuar listën e projekteve të aprovuara me procesin tarifor dhe nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2024. Me qëllim të monitorimit të investimeve kapitale të aprovuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, ARRU, komfor mandatit ligjor, ka realizuar takime në të gjitha KRU-të, për të vlerësuar nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2024. Takimet janë realizuar ndaras me secilën KRU, përkatësisht takimet janë mbajtur me zyrtarë të Departamentit Teknik dhe të Departamentit të Financave të KRU-ve, për të diskutuar listën e projekteve të aprovuara me procesin tarifor dhe nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2024. Monitorimi i zbatimit të investimeve kapitale nga Departamenti i Tarifave të ARRU është e ndërlidhur edhe me auditimin e të dhënave që ka bërë paraprakisht Departamenti i Performancës. Si vlera të besueshme të investimeve të realizuara janë marrë të dhënat nga procesi i auditimit të të dhënave, të shpërndara sipas kategorive të Udhëzuesit të Kontabilitetit Rregullator. Ky raport merr për bazë të dhënat e realizuara nga KRU për vitin 2024 në bazë të shënimeve të marra gjatë procesit të auditimit të të dhënave si dhe krahason të dhënat e projekteve të investimeve kapitale, sipas BPRR, duke vlerësuar statusin e realizimit të tyre në bazë të të dhënave të marra gjatë takimit dhe dokumenteve përcjellëse të dërguara nga KRU-të përmes e-mailit.

## **Investimet e aprovuara për KRU "Prishtina"**

Procesi tarifor 2022/2024, bartës i të cilit është ARRU, ka një komponentë tejet të rëndësishme që janë investimet kapitale që KRU-të planifikojnë t'i realizojnë gjatë periudhës tre vjeçare. Lista e investimeve kapitale pastaj shpërndahet në kategori të caktuara sipas Udhëzuesit të Kontabilitetit Rregullator dhe si e tillë ka ndikim të drejtpërdrejtë në lartësinë e tarifës, rrjedhimisht edhe në të ardhurat e KRU. ARRU ka pranuar Listën e Investimeve Kapitale të realizuara nga KRU. KRU sipas udhëzimeve të ARRU, për secilin projekt të propozuar ka përgatitur një arsyetim, pjesën përshkuese si dhe paramasën dhe paralogarinë për projektet e listuara. Pas pranimit të aplikacionit tarifor, ARRU mbështetur në parimet bazë për përballueshmërinë e faturës nga ana e konsumatorit dhe për të ruajtur nivelin e shërbimit të KRU-së, ka bërë ndërhyrje në vlerat e projekteve të investimeve kapitale prej burimeve vetjake. Këto ndërhyrje në tekstin e më poshtëm përkufizohen me shprehjen "Rregullimet nga ARRU". Në disa raste janë shtuar vlera të investimeve kurse në raste tjera janë zbritur vlera të investimeve. Këto rregullime u janë dërguar KRU-së të cilës u është kërkuar që të dërgojnë e listën e azhurnuar komfor ndërhyrjeve nga ARRU. Listën e azhurnuar KRU-ja nuk e ka dërguar në ARRU, e cila gjë e ka vështirësuar analizën e realizimit të investimeve sipas projekteve.

## **Investimet e realizuara nga KRU-të sipas procesit të auditimit të të dhënave**

Ekipi i ARRU-së për auditimin e të dhënave, pas takimit të mbajtur në KRU, ka marrë të dhënat e realizuara të investimeve kapitale nga moduli i kontabilitetit. Ato investime të cilat kanë qenë të regjistruara në modul të kontabilitetit, të cilat, njëherësh, plotësojnë kriteret për t'u regjistruar në kontabilitet, janë njohur nga ARRU si investime të realizuara për periudhën përkatëse, në këtë rast për vitin 2024. Për nevoja të krahasimit, në tabelën vijuese do të paraqiten shumat e investimeve kapitale, të ndara sipas kategorive, ku do të jenë investimet e aprovuara nga ARRU dhe pastaj shumat e realizuara nga KRU. Monitorimi i Listës së Investimeve Kapitale konsiston në verifikimin e projekteve të dorëzuara nga KRU sipas Listës, e cila si e tillë, përveç emrit të projektit ka edhe dokumentin mbështetës me përshkrim, arsyetim, para masë dhe para llogari të projektit të caktuar. Ekipi nga ARRU ka diskutuar dhe vlerësuar implementimin e projekteve sipas Listës së investimeve me përfaqësuesit e KRU, prej nga ka marrë informacione rreth statusit aktual për secilin projekt.

**Tabela nr.1 Investimet kapitale- nga burimet vetjake të financimit ujë**


| <b>Emërtimi</b>                      | <b>2024 BPRR</b> | <b>2024 të realizuara</b> |
|--------------------------------------|------------------|---------------------------|
| Përtërirja e infrastrukturës         | 576,000.00       | 5,428.00                  |
| Rritja e Infrast.                    | 20,000.00        | 266,492.00                |
| Mirëmbajtja kap e jo-infrastrukturës | 352,600.00       | 32,874.00                 |
| Rritja e jo-infrast.                 | 350,000.00       | 181,789.00                |
| Aktivitetet biznesore                | 318,000.00       | 275,430.00                |
| <b>Totali</b>                        | <b>1,616,600</b> | <b>762,013.00</b>         |

**Tabela nr.2-Investimet kapitale- nga burimet vetjake të financimit – ujëra të ndotura**

| <b>Emërtimi</b>                      | <b>2024 BPRR</b>  | <b>2024 të realizuara</b> |
|--------------------------------------|-------------------|---------------------------|
| Përtërirja e infrastrukturës         | 195,000.00        | -                         |
| Rritja e Infrast.                    | -                 | -                         |
| Mirëmbajtja kap e jo-infrastrukturës | 370,000.00        | -                         |
| Rritja e jo-infrast.                 | -                 | -                         |
| Aktivitetet biznesore                | 32,000.00         | 68,848.00                 |
| <b>Totali</b>                        | <b>597,000.00</b> | <b>68,848.00</b>          |

**Tabela nr 3 Realizimi i investimeve kapitale, për ujë dhe ujëra të ndotura- të realizuara si dhe Investimet në Vijim (2024) - shprehur në %-je:**

| Emërtimi         | Planifikuar         | Investimet e kryera | % e realizimit |
|------------------|---------------------|---------------------|----------------|
| Ujë              | 1,616,600.00        | 762,013.00          | 47.13          |
| Ujëra të ndotura | 597,000.00          | 68,848.00           | 11.53          |
| <b>Totali</b>    | <b>2,213,600.00</b> | <b>830,860.31</b>   | <b>37.53</b>   |



**Figura 1. Grafiku i krahasimit të realizimit të investimeve të planifikuara dhe të realizuara.**

## Konkluzione

- Ofruesi i shërbimeve - për ujë - i ka realizuar në vlerë financiare, vetëm për 47 %;
- Ofruesi i shërbimeve i ka realizuar investimet në vlerë financiare për ujërat e ndotura, shprehur në përqindje, për 11 %;
- Ofruesi i shërbimeve nuk iu ka përmbajtur strukturës së investimeve sipas kategorizimeve rregullatore,
- Ofruesi i shërbimeve nuk ka arritur që t'i përmbahet në plotëni 'Listës së aprovuar të investimeve kapitale', të aprovuar me BPRR- për vitin 2024 nga ARRU-ja;
- Ofruesi i shërbimeve, pas miratimit të BPRR, nuk e ka sjellur listën e azhurnuar të investimeve, komfor vlerave dhe kategorive investuese, të aprovuara nga ARRU-ja;
- Ofruesi i shërbimeve planin e investimeve vetjake, sipas BPRR, e ka realizuar 37.53 %
- Ofruesi i shërbimeve ka investuar në projekte me emërtime konkrete, por nuk ka arritur që t'i përfundoj në vitin 2024;
- Ofruesi i shërbimeve, në vitin 2024, gjithsej investime në projekte të emërtuara me emër të përveçëm dhe me procedura të rregullta të tenderimit, ka realizuar në vlerë prej 830,860.31 €.
- Nga ofruesi i shërbimeve është pritur një performim më i mirë në ofrimin e raporteve të kërkuara.

## Rekomandime

- Ofruesi i shërbimeve duhet që t'i përmbahet strikt BPRR, të aprovuar nga ARRU;
- Ofruesi i shërbimeve duhet që t'i përmbahet me përpikëri strukturës së 'Listës së kontrollit të investimeve';
- Ofruesi i shërbimeve duhet që t'i përmbahet planit për investime, sipas kategorive edhe tek investimet e ujërave të ndotura;
- Ofruesi i shërbimeve duhet që në ARRU ta dorëzojë me kohë 'Listën e azhurnuar të investimeve, sipas BPRR, të aprovuar nga ARRU.
- Ofruesi i shërbimeve duhet që të jetë më i vëmendshëm që projektet e aprovuara me BPRR, që t'i përfundojë dhe t'i regjistrojë si asete brenda vitit fiskal të miratuar.
- Rekomandohet ofruesi i shërbimeve, që të ketë evidencë të qartë financiare për investimet në vijim'
- Për investimet e pa planifikuara, ofruesi i shërbimeve, duhet që të kërkoj miratimin e ARRU-së,
- Ofruesi i shërbimeve, rekomandohet, që në Biznes Plan, ta vendosë një buxhet për investimet e pa planifikuara,
- Ofruesi i shërbimeve rekomandohet, që të ketë një planifikim financiar për kontigjenca.